VENDIM
Nr. 208, datë 7.10.2024

MBI FILLIMIN E PROCEDURËS LIDHUR ME SHQYRTIMIN E KËRKESËS SË SHOQËRISË "ERSEKA SOLAR PARK 1" SHPK, PËR LICENCIM NË VEPRIMTARINË E TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të neneve 16 dhe 37, pika 2, germa "d", të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar; të neneve 4, pika 1, germa "e", 5, pika 1, germa "e", dhe 10, pikat 1 dhe 3, të "Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike", të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar; si dhe të neneve 15 dhe 19, pika 1, germa "a", të "Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s", miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 7.10.2024, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 2021/1 prot., datë 3.10.2024, të Drejtorisë së Licencimit dhe Autorizimeve "Mbi kërkesën e shoqërisë 'Erseka Solar Park 1' sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike",

konstatoi se:

- Shoqëria "Erseka Solar Park 1" sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 2021 prot., datë 1.10.2024, paraqiti kërkesën për licencim në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.
- Nga shqyrtimi i aplikimit, në referencë të përcaktimeve të "Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike", të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar, rezulton se shoqëria ka kryer pagesën e aplikimit sipas përcaktimeve të aneksit A, të rregullores dhe ka plotësuar dokumentacionin e kërkuar në zbatim të nenit 9, për pikën 1.1, germat: "a" "b" dhe "c"; për pikën 1.2, germat: "a", "b", "c" dhe "d"; për pikën 1.3, germat: "a", "b" dhe "c"; si dhe pikën 2.5.
- Dokumentacioni i këtij aplikimi është tërësisht i plotësuar.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë "Erseka Solar Park 1" sh.p.k. në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.
2. Drejtoria e Licencimit dhe Autorizimeve të njoftojë shoqërinë "Erseka Solar Park 1" sh.p.k. për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti